



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development



UNIVERSITETI HAXHI ZEKA
PEJË

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

-NDËRMJET-

MINISTRISË SË ZHVILLIMIT RAJONAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

UNIVERSITETIT "HAXHI ZEKA"
PEJË/KOSOVË

Hyrje

Ministria e Zhvillimit Rajonal e Republikës së Kosovës dhe Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, në tekstin e mëtejshëm "Palët", me qëllim të krijimit, zhvillimit dhe forcimit të bashkëpunimit dypalësh në fushën e avancimit të zhvillimit rajonal, ranë dakord si më poshtë:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është krijimi, zhvillimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit midis dy institucioneve si dhe përcaktimi i kornizës së bashkëpunimit në funksion të promovimit të zhvillimit të balancuar socio-ekonomik rajonal në Kosovë në përputhje me prioritetet e MZHR-së dhe Universitetit "Haxhi Zeka". Kjo marrëveshje përcakton bazën dhe mënyrat e ardhshme të bashkëpunimit në fushën e zhvillimit rajonal.

Neni 2 Fushat e Bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi i palëve në kuadër të këtij memorandum do të zhvillohet në fushat si në vijim:
 - 1.1 Hartimi i politikave në fushën e zhvillimit rajonal, përgaditja dhe zbatimi i dokumenteve strategjike, koordinimi dhe monitorimi i politikave rajonale dhe format tjera të bashkëpunimit;
 - 1.2 Realizimi i hulumtimeve të përbashkëta në fushën e zhvillimit rajonal;
 - 1.3 Krijimi i Forumit për Zhvillim Ekonomik Rajonal;
 - 1.4 Ndërmjetësimi, rrjetëzimi, nxitja e proceseve mësimore dhe formësimi i kapaciteteve institucionale;
 - 1.5 Ndihma në planifikimin rajonal, zhvillimin e ideve të reja inovative, hartimin, zbatimin dhe menaxhimin e strategjive për zhvillim rajonal;
 - 1.6 Pjesëmarrja në mekanizmat qeverisës, bordet/grupet këshilluese dhe kontributi me ekspertizë në fushën e zhvillimit rajonal;
 - 1.7 Krijimi i lidhjeve ndërmjet rrjeteve locale dhe ndërkombëtare akademike;
 - 1.8 Çështje të tjera të përgjithshme për të cilat palët mund të pajtohen, në përputhje me qëllimin e këtij memorandum.

Neni 3 Format e Bashkëpunimit

1. Palët zotohen për zbatimin e formave të bashkëpunimit si në vijim:
 - 1.1 Pjesëmarrja në trajnime, grupe punuese, hulumtime, seminare, punëtori dhe vizita të përbashkëta studimore në fushat e bashkëpunimit bazuar në këtë memorandum;
 - 1.2 Shkëmbimi i informacioneve, dokumentacionit dhe materialeve tjera relevante, si dhe përgaditja e programeve/projekteve të ndryshme në lidhje me fushat e bashkëpunimit;
 - 1.3 Takime dhe vizita të nëpunësve civil, stafit, studentëve nga dy institucionet si dhe ekspertëve që punojnë në çështjet e zhvillimit rajonal;
 - 1.4 Format tjera të bashkëpunimit për të cilat pajtohen palët.

Neni 4 Koordinimi i aktiviteteve

1. Do të krijohet një grup i përbashkët punues, duke përfshirë përfaqësues të të dyja palëve për ta siguruar efikasitetin e bashkëpunimit. Secila palë do ta caktoj një koordinator, i cili do të jetë personi kryesor kontaktues dhe do ta siguroj koordinimin, monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të dakorduara për bashkëpunim.
2. Koordinatorët apo përfaqësuesit e tyre i organizojnë aktivitetet për zbatimin e këtij Memorandumi.

Neni 5
Financimi

Secila Palë i mbulon shpenzimet e saj që mund të dalin nga bashkëpunimi sipas këtij Memorandumi, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe fondet e aprovuara buxhetore, apo sipas dakordimit ndërmjet dy palëve. Për financimin e aktiviteteve të caktuara të dyja palët mund të aplikojnë për financim nga burime tjera.

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjes

1. Të gjitha çështjet që dalin nga interpretimi ose zbatimi i këtij memorandum, zgjidhen ndërmjet palëve.
2. Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që lind, ose mund të lind nga ose gjatë zbatimit të këtij memorandum, zgjidhet me anë të konsultimeve dhe bisedemeve ndërmjet tyre.

Neni 7
Dispozitat përfundimtare

1. Memorandumi i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
2. Ky memorandum është i detyrueshëm për një periudhë të pacaktuar, deri kur palët vendosin që i njehti të ndërprehet me marrëveshje;
3. Secila palë mund të ndërprej memorandumun e bashkëpunimit duke e njoftuar njëra/tjetrën me shkrim përmes kanaleve institucionale.
4. Ndërprerja dhe përfundimi i këtij memorandum nuk do të ndikoj në zbatimin e programeve dhe projekteve të miratuara në bazë të memorandumit që janë nisur përpara datës së përfundimit të Memorandumit, përveç nëse palët bien dakord ndryshe.
5. Ky memorandum i bashkëpunimit mund të ndryshohet me pëlqimin e palëve nënshkruese.
6. Memorandumi i bashkëpunimit nënshkruhet në Pejë, më 13.06.2023, në dy kopje origjinale

Për
Ministrinë e Zhvillimit Rajonal
Fikrim Damka
Ministër

Për
Universitetin "Haxhi Zeka"
Prof. Dr. Armand Krasniqi

Rektor



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRI E ARSIMIT,
SHKENCËS
DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERSITET
"HAXHI ZEKAI"
PEJE

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1541	Nr. /faq/ Bx. sir / No. pg 2
Data / Datum / Date: 13 / 06 / 2023	